

UDHËZIM
Nr. 1, datë 19.2.2018

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE MINIMALE PËR HARTIMIN
E PLANEVE TË VEPRIMIT
PËR ZHURMAT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20, pika 2, të ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Planet e veprimit për menaxhimin e zhurmës në mjedis hartohen në përmbushje të kërkesave dhe standardeve të parashikuara në ligjin për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis.
2. Planet e veprimit harmonizohen me planet e tjera vendore, rajonale dhe kombëtare për zhvillimin e territorit dhe planet e zhvillimit ekonomik.
3. Planet vendore të veprimit për menaxhimin e zhurmës i referohen edhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Zhurmave dhe parashikojnë, programojnë masa dhe aktivitete në përmbushje të objektivave kombëtarë dhe objektivave specifike dhe të veçantë vendorë. Ministria përgjegjëse për menaxhimin e zhurmës në mjedis, në bashkëpunim me ministritë, fusha e përgjegjësisë e të cilave lidhet me menaxhimin e zhurmës në mjedis, janë përgjegjëse për hartimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave.
4. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e planeve vendore të veprimit për zhurmat.
5. Planet e veprimit hartohen, konsultohen dhe miratohen pas një procesi transparent dhe me pjesëmarrjen e të gjithë grupeve të interesit.

KREU II
**QËLLIMI I PLANEVE TË VEPRIMIT
PËR MENAXHIMIN E ZHURMAVE
NË MJEDIS**

1. Planet e veprimit janë një dokument, i cili hartohet duke analizuar dhe duke marrë në konsideratë planet dhe programet e zhvillimit ekonomik dhe mjedisor, që ka miratuar ose janë në proces miratimi nga organet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore.
2. Këto plane njëkohësisht shërbejnë si një dokument orientues për planet kombëtare, rajonale dhe vendore për zhvillimin ekonomik dhe për planet e territorit.
3. Plani vendor parashikon masa, aktivitete, si dhe objektiva që duhet të përmbushë njësia vendore në respektim të ligjit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
4. Plani vendor ka për qëllim gjithashtu të analizojë së pari situatën në të cilën gjenden njësitë e qeverisjes vendore lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit për mbrojtjen nga zhurmat, vlerësimin e shqetësimeve të komunitetit dhe të bizneseve lidhur me zhurmat, si dhe vlerësimin e përvojave më të mira në këtë fushë.
5. Konsultimi me publikun dhe marrja e mendimit të tij është një ndër elementet më të rëndësishme dhe që garanton zbatimin e planeve të veprimit dhe arritjen e objektivave të tyre në nivel kombëtar dhe vendor.

KREU III

OBJEKTIVAT E PLANEVE TË VEPRIMIT TË ZHURMAVE NË MJEDIS

1. Planet e veprimit duhet të përmbajnë dhe programojnë disa objektiva, të cilat duhet të jenë parashikuar qartë lidhur me afatet e zbatimit të tyre, kostot e nevojshme për arritjen e objektivave, si dhe indikatorët për matjen dhe vlerësimin e performancës së secilit objektiv. Ndër objektivat më kryesorë që duhet të integrohen në planet e veprimit janë:

- a) Identifikimi dhe vlerësimi i burimeve që gjenerojnë zhurmë dhe shkaktojnë ndotje akustike;
- b) Vlerësimi i shkallës së ndikimit të secilit burim në ndotjen akustike, me qëllim parashikimin e masave të nevojshme për reduktimin apo eliminimin e zhurmave në mjedis;
- c) Analiza e kuadrit ligjor ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor lidhur me përgjegjësitë e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe operatorëve ekonomikë, për respektimin e kërkesave ligjore lidhur me menaxhimin e zhurmave në mjedis;
- d) Analiza dhe vlerësimi i planeve dhe programeve kombëtare, rajonale dhe vendore, të cilat duhet të respektojnë kërkesa dhe standarde, lidhur me nivelin dhe menaxhimin të zhurmave në mjedis;
- e) Planet dhe programet që janë të lidhura me ato të zhvillimit urban, infrastrukturës etj.;
- f) Politikat e Bashkimit Europian dhe ato kombëtare lidhur me zhurmat dhe përshtatjen e planeve të veprimit në përmbushje të këtyre politikave;
- g) Përlllogaritja e kostove dhe planifikimi i fondeve të nevojshme për zbatimin e planeve të veprimit të menaxhimit të zhurmave;
- h) Objekt i këtyre planeve, në përputhje të legjislacionit kombëtar me atë Evropian, janë:
 - i) aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor (klube nate, bare, restorante, disko);
 - ii) sektori i transportit (rrugor, ajror, ujor dhe hekurudhor) dhe zhurmat që gjeneron ky sektor;
 - iii) aktivitet ekonomike që përdorin pajisje dhe makineritë që gjenerojnë zhurma, si sharra, elektromotorët, gjeneratorët, çekiçë pneumatikë etj.).

KREU IV

AKTIVITETET E SHËRBIMIT SOCIAL DHE KULTUROR

1. Në zonat dhe qendrat urbane dhe turistike, një ndër burimet kryesore të ndotjes akustike është edhe sektori i shërbimeve sociale, që përfshin baret, restorantet klubet e natës, disko etj. Plani vendor i veprimit për këtë sektor duhet të vlerësojë dhe rekomandojë:

- a) vlerësimin e situatës, identifikimin e aktiviteteve, vendndodhjen e tyre, si dhe numrin e personave të ekspozuar nga zhurmat që gjenerojnë këto aktivitete;
- b) vlerësimin e kushteve specifike në licencimin e tyre dhe respektimin e kërkesave të ligjit për menaxhimin e zhurmave në mjedis;
- c) vlerësimin e zonave që duhet të konsiderohen të qeta, si territoret afër shkollave, kopshteve, çerdheve, spitaleve etj.;
- d) ngritjen dhe funksionimin e një strukture për monitorimin dhe kontrollin e zhurmave në mjedis, si përgjegjësi e pushtetit vendor për të kontrolluar dhe administruar territorin;
- e) Për secilin aktivitet të sektorit të shërbimeve sociale, që gjeneron zhurma në mjedis, plani duhet të parashikojë dhe miratojë nivelet dhe oraret e lejuara të zhurmave në mjedis. Këto norma dhe orare duhet të jenë në përputhje me kërkesat e udhëzimit për miratimin e normave të lejuara të zhurmave në mjedis.

KREU V

SEKTORI I TRANSPORTIT

1. Sektori i transportit konsiderohet si një nga sektorët që gjeneron zhurma të konsiderueshme

dhe që shkakton shqetësime për qytetarët. Plani vendor i veprimit për zhurmat në mjedis duhet të parashikojë dhe programojë një sërë masash, me qëllim parandalimin e ndotjes akustike dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetareve dhe një sërë aktiviteteve si:

a) vlerësimin e popullsisë së ekspozuar ndaj zhurmave që gjenerohen nga sektori i transportit, rrugor, hekurudhor dhe ajror;

b) analizën dhe vlerësimin e numrit të mjeteve të transportit rrugor, ajror, hekurudhor dhe ujor që lëvizin dhe oraret e tyre të lëvizjes, duke veçuar dhe analizuar periudhat e pikut të transportit;

c) vlerësimin e ekspozimit të institucioneve publike, si shkolla, spitale, kopshte, çerdhe, shtëpi të moshuarish, ndaj këtyre zhurmave;

d) vlerësimin e sinjalistikës të transportit dhe integrimi në këtë sinjalistikë i elementeve lidhur me ndalimin e zhurmave në mjedis ose reduktimin e tyre.

2. Plani vendor i veprimit, në bazë të analizës dhe vlerësimeve për çështjet e trajtuara më lart, planifikon dhe programon masat e nevojshme që duhen ndërmarrë me qëllim reduktimin ose parandalimin e zhurmave nga sektori i transportit publik. Ky plan duhet të përmbajë:

a) rishikimin dhe përshtatjen e transportit rrugor, ajror, hekurudhor dhe ujor në respektim të kërkesave ndaj ligjit për zhurmat;

b) rishikimin e sinjalistikës të transportit rrugor, ajror, hekurudhor dhe ujor dhe integrimin e standardeve për mbrojtjen nga zhurmat;

c) vlerësimin e regjimit të transportit rrugor, ajror, hekurudhor dhe ujor dhe parashikimin e masave të nevojshme për çdo ndërhyrje, në akset apo pikat ku niveli i zhurmave është mbi normat e lejuara kombëtare;

d) parashikimin dhe zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen nga zhurmat, nëpërmjet vendosjes së barrierave mbrojtëse ndaj zhurmave. Këto barriera duhet të parashikohen në rastet kur afër rrugëve ndodhen shkollat, spitale, qendra banimi etj.;

e) masat duhet të planifikohen qartë në aspektin kohor të zbatimit të tyre, si dhe përcaktimin e indikatorëve për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e masave për reduktimin dhe eliminimin e zhurmave nga sektori i transportit.

KREU VI

PAJISJET DHE MAKINERITË QË GJENEROJNË ZHURMA

1. Zhurma dhe shqetësimet akustike vijnë edhe nga pajisje dhe makineri që përdoren nga sektori i industrisë, energjisë dhe punëve publike. Në planin kombëtar për menaxhimin e zhurmave në mjedis duhet të parashikohen një sërë pajisjesh dhe makinerish, të cilat janë pjesë e ligjit për zhurmat dhe në direktivën kuadër të Bashkimit Evropian për zhurmat.

2. Plani vendor i veprimit duhet të parashikojë dhe programojë masa të nevojshme për parandalimin apo reduktimin e zhurmave nga ky sektor. Për të arritur në një planifikim dhe programim të masave, është e nevojshme që, paraprakisht, të bëhet një vlerësim dhe analizë e situatës që ka njësia e qeverisjes vendore, lidhur me këtë sektor. Ky vlerësim dhe analizë duhet të përqendrohet në:

a) vlerësimin e burimeve kryesore të ndotjes nga pajisjet dhe makineritë dhe rolin dhe ndikimin që ato kanë tek qytetarët;

b) vlerësimin e popullsisë së ekspozuar ndaj këtyre zhurmave dhe veçanërisht institucionet e trajtuara edhe me lart si shkolla, kopshte, spitale etj.;

c) analizën dhe mundësitë e eliminimit apo reduktimit të ndotjes akustike nga këto burime.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministria përgjegjëse për menaxhimin e zhurmës në mjedis, në bashkëpunim me ministrinë tjetër, fusha e përgjegjësisë e të cilave lidhet me menaxhimin e zhurmës në mjedis, që gjatë hartimit të planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave të mbajnë në konsideratë kërkesat minimale të përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore, që gjatë hartimit të planeve vendore të veprimit për zhurmat, të mbajnë në konsideratë kërkesat minimale të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi